

VENDIM
Nr. 63, datë 27.5.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
“RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË
PLANIT TË INVESTIMEVE NGA OPERATORËT E TRANSMETIMIT DHE
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TË LICENCUARVE QË
MBARTIN DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “e”, 60, pika 9 dhe 75, pika 8, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin për “Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të licencuarit që mbartin detyrimin e shërbimit publik”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të të licencuarit që mbartin detyrimin e shërbimit publik”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsu-matorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti